



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2021:210188

Datë: 10.01.2022

Numri i dokumentit: 02589118

PPP.nr.39/2021

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG, si përmbarimore, me gjyqtarin individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike të kreditorit S. & A. LL.C me nr te biznesit Rr. N. K. Objekti L C. I B Nr. P. , kundër debitorit F. B. Rr. E. S. nr. Istog, për shkak të borxhit në shumë prej 250€, pas prapësimit të ushtruar nga debitori me dt: 03.09.2021, kundër urdhrimit mbi lejimin e përmbarimit, jashtë seance me dt.10.01.2022 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET prapësimi i debitorit F. B. nga Istogu, ushtruar kundër urdhrimit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.852/2021 të dt.24.08.2021, si dhe **SHFUQIZOHET** urdhri mbi lejimin e përmbarimit P.nr.852/2021 të dt.24.08.2021, dhe të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore abrogohen.

A r s y e t i m

Kreditori, S. & A. LL.C me nr te biznesit Rr. N. K. Objekti L C. I B Nr.. P. , ka ushtruar propozim për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës, duke kërkuar që të lejohet përmbarimi dhe të obligohet debitori pagesën e borxhit në shumë prej 250 €, me kamat ligjore 8 % dhe shpenzimet e procedurës përmbarimor, të gjitha në afat 7 ditor nga dita e pranimit të propozimit, në të kundërtën ti bllokoj të gjitha llogarit bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjetet monetare në llogari të behet sekuestrimi, regjistrimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të pa luajtshme, të gjitha të specifikuara në propozimin e dt. 23.08.2021.

Përmbaruesi privat, me urdhrin P.nr.852/2021 të dt.24.08.2021, e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit në këtë çështje përmbarimore.

Debitori, F. B. Rr. E. S. Nr. Istog, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim kundër urdhrimit përmbarimor, me kërkesë që të anulohet urdhri përmbarimor

me arsyetimin se dokumenti me te cilin është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet ligjore për tu konsideruar dokument i besueshëm pasi që e njëjta faturë nuk është e pranuar dhe nënshkruar nga ana e debitorit, po ashtu e njëjta është e dorëzuar ne kopje. Me tutje shton se përfaqësimi ka qenë zyrtar andaj pagesa i bie barra gjykatës kompetente.

Pas ngritjes se prapësimit nga debitori, kreditori ka ushtruar përgjigje ne prapsim me kërkesë që te njëjtin ta refuzoj si te pa bazuar me arsyetimin se debitori me prapsim si arsyeje te vetme e ka prolongimin e procedurës, ku fature e ka pranuar ne mënyrë te rregullt ne email dhe WhatsApp, e njëjta faturë është ne origjinal dhe i ka te gjitha tiparet e përmnarueshmerisë. Po ashtu pretendimet rreth përfaqësimit lehtë vërtetohen nga autorizimi si dhe nga komunikimi me dhe WhatsApp, ku debitori e ka angazhuar për përfaqësim te prindit të tije, dhe nga momenti i dorëzimit te autorizimit tek gjyqtari dhe tek prokurori avokati e përfaqëson palën me autorizim dhe nuk është av sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Themelore në Pejë- Dega Istog, si përmbartimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se i njëjti është i bazuar. Arsyet e paraqitura në prapësim të debitorit tregojnë shkaqe sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, sipas të cilave do të pengohet përmbartimi i lejuar me urdhër përmbartimor.

Gjykata, pas shqyrtimit te prapësimit si dhe pas shqyrtimit te provave tjera ne shkresat e lëndës, si dhe lidhur me pretendimet e debitorit lidhur me atë se dokumenti me te cilin është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet ligjore për tu konsideruar dokument i besueshëm pasi që e njëjta faturë nuk është e pranuar dhe nënshkruar nga ana e debitorit, te njëjtit pretendime gjykata i aprovoj si te bazuara për faktin se në këtë çështje përmbartimore nuk janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e këtij urdhri përmbartimor, ngase i njëjti është lejuar në bazë të dokumentit i cili nuk i ka tiparet e përmbarushmerisë, sepse Fatura me numër 2021-14 e datës 05.08.2021, është e pa nënshkruar nga këtu pala debitorë, andaj duke ju referuar nenit 29 par. 1, nën par. 1.1 dhe par.1.3 të LPP-së, e cila dispozitë shprehimisht përcakton se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: kambialet dhe çeket me post dhe faturë kthyese, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës”. Nga çka rezulton se fatura e cila është objekt i përmbartimit në këtë çështje përmbartimore, për tu konsideruar faturë kthyese dhe për tu plotësuar ky kusht ligjor është dashur që te jete e nënshkruar nga kreditori dhe debitori, e jo si ne rastin konkret e cila nuk është e nënshkruar nga pala debitore, por vetëm nga kreditori, e si e tillë konsiderohet si faturë jo kthyese.

Gjykata ne bazë te rrethanave te krijuara, pasi që vendimin me të cilin është lejuar përmbartimi nuk i plotëson tiparet e përmbarueshmerisë, nuk u lëshua ne vlerësimin e pretendimeve tjera te palëve në këtë procedurë, ashtu që vendosi si ne dispozitiv te këtij aktvendimi duke e aprovuar prapësimin e

debitorit dhe duke shfuqizuar urdhrin përmbarimor si dhe i abrogoj te gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore.

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, konform dispozitave të nenit 3, 29, 69, 71 e 73 par. 3, të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG
PPP.nr.39/2021 dt.10.01.2022

GJ Y Q T A R I
Blerim Istrefi

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, ne afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.